




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 403 , datë 9.6.2022

P Ë R

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË PERSONELIT TË POLICISË
SË BURGJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 28, pika 3, e 42, pika 4, të ligjit nr.80/2020, "Për Policinë e Burgjeve", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores së personelit të Policisë së Burgjeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletorën zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDIRAMA

MINISTRI I DREJTËSISË

ULSI MANJA

RREGULLORE E PERSONELIT TË POLICISË SË BURGJEVE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave për pranimin, trajnimin dhe ecurinë në karrierë të punonjësve të Policisë së Burgjeve në kuadër të garantimit të profesionalizmit, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së ushtrimit të detyrës nga Policia e Burgjeve.

Neni 2 Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të hollësishme për pranimin, trajnimin e detyrueshëm fillestar, trajnimin vazhdues të punonjësve të Policisë së Burgjeve, si dhe procedurave të detajuara për kryerjen e trajnimit përkatës profesional për ecurinë në karrierë.

Neni 3 Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) **“Certifikatë e formimit fillestar”**, vërtetimi që lëshohet për përfundimin me sukses të trajnimit fillestar, sipas përcaktimeve në këtë rregullore;
- b) **“Certifikatë e trajnimit profesional”**, vërtetimi që lëshohet me përfundimin me sukses të trajnimit profesional për marrjen e gradës së radhës;
- c) **“Trajnim fillestar”**, trajnimi i kryer nga kandidatët e përzgjedhur për t’u pranuar si punonjës të Policisë së Burgjeve;
- ç) **“Trajnim profesional”**, trajnimi i kryer nga punonjësit e Policisë së Burgjeve me qëllim fitimin e gradës pasardhëse;
- d) **“Trajnim vazhdues”**, trajnimet e kryera gjatë gjithë karrierës së punonjësit të Policisë së Burgjeve, nga emërimi deri në përfundimin e marrëdhënieve të punës, që synojnë rritjen e shkallës së profesionalizmit në mënyrë të pandërprerë për t’iu përgjigjur kërkesave profesionale;
- dh) **“Qendra e Trajnimit”**, njësia përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për trajnimin fillestar, trajnimin vazhdues e trajnimin profesional në Policinë e Burgjeve.

KREU II

RREGULLAT E DETAJUARA PËR PRANIMIN E PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE

Neni 4

Pranimi në Policinë e Burgjeve

1. Pranimi në Policinë e Burgjeve kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës, transparent e të drejtë. Kriteret për pranimin në Policinë e Burgjeve janë sipas parashikimeve të bëra në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve.
2. Pranimi në Policinë e Burgjeve bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve, integritetin, humanizmin, përshtatshmërinë personale për punën komplekse që do të kërkohet nga ata. Pranimi në Policinë e Burgjeve përfshin një testim me shkrim, një testim me gojë, testim psikologjik, si dhe vlerësimin e aftësive fizike e profesionale të kandidatit.
3. Çdo person, që plotëson kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve, ka të drejtë të konkurrojë për t'u pranuar si punonjës i Policisë së Burgjeve, duke paraqitur dokumentet provuese për përmbushjen e të gjitha kriterëve ligjore.
4. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, që kanë të drejtë të rikthehen në shërbim, si dhe për shtetasit që kanë përvojë pune në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe Forcat e Armatosura, në zbatim të nenit 55, të ligjit nr.80/2020, "Për Policinë e Burgjeve", kanë përparësi për pranimin në Policinë e Burgjeve.

Neni 5

Njoftimi për fillimin e procesit të pranimit

1. Brenda datës 31 janar të çdo viti, struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve evidenton numrin e vendeve të lira në Policinë e Burgjeve, mbështetur në numrin e punonjësve të liruar e të larguar nga Policia e Burgjeve, si dhe në vendet e lira, që krijohen për shkak të ndryshimeve strukturore.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve shpall procedurën e pranimit në Policinë e Burgjeve, duke e publikuar në:
 - a) faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve;
 - b) median e shkruar; si dhe
 - c) në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit".

3. Në shpalljen e bërë përcaktohen numri i vendeve të planifikuara për pranim, fazat e konkurrimit, kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët, dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyra e dorëzimit të tyre, afati i dorëzimit të dokumenteve, si dhe data e publikimit të rezultateve për fazën e vlerësimit paraprak të kandidatëve.
4. Afati për aplikimin në Policinë e Burgjeve është 20 (njëzet) ditë nga e nesërmja e shpalljes së procesit të pranimi.

Neni 6

Shqyrtimi i aplikimit

1. Struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e përfundimit të procesit të aplikimit, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
2. Në përfundim të verifikimit, kandidatët, të cilët plotësojnë kriteret për të qenë punonjës të Policisë së Burgjeve, renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Kandidatët që janë në listë njoftohen për vijimin e procedurave dhe afatet e testimit. Kjo listë publikohet gjithashtu në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe në faqen zyrtare të saj.
3. Kandidatët, që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse për moskualifikimin e tyre. Dokumentacioni përkatës dhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave administrohen nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.
4. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, kandidatët që nuk janë kualifikuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, i cili shprehet me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga data e paraqitjes së ankimit. Në rastet kur ankimi vlerësohet i bazuar, kandidati vazhdon konkurrimin.

Neni 7

Komisioni i testimit

1. Procedura e testimit me shkrim kryhet nga Komisioni i Përhershëm i Testimit, i ngritur nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

2. Komisioni përbëhet nga:

- a) 2 (dy) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
- b) 3 (tre) përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

3. Komisioni njoftohet nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për datën e zhvillimit të testimit dhe listën e kandidatëve.

4. Anëtar i komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër të komisionit, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, të mos marrë pjesë në zhvillimin e testimit dhe në vlerësimin e tij.

Neni 8

Organizimi i testimit

1. Rregullat për organizimin e testimit të pranimit në Policinë e Burgjeve janë, si më poshtë vijon:

- a) Në hyrje të ambientit ku zhvillohet testimi afishohet lista e kandidatëve të pranuar për konkurrim;
- b) Në ambientin ku zhvillohet testimi bëhet regjistrimi i kandidatëve;
- c) Kandidati duhet të paraqitet në testimin me shkrim i pajisur me letërnjoftim dhe, pasi të verifikohet nga ana e regjistruesve, bëhet regjistrimi i tij;
- ç) Kandidatët orientohen të hyjnë në sallë nga punonjësit e ngarkuar për këtë qëllim;
- d) Pas regjistrimit, kandidatëve u jepet fleta e testimit dhe u komunikohet koha që kanë në dispozicion për kryerjen e testimit;
- dh) Gjatë gjithë testimit, kandidatët monitorohen që të mos kopjojnë ose të flasin me njëri-tjetrin, të mos përdorin telefonat celularë, makinat llogaritëse apo mjet tjetër, përveç atyre që u jepen nga komisioni;
- e) Kur konstatohet se kandidatët shkelin rregullat, komisioni merr masa për t'i larguar menjëherë nga testimi;
- ë) Në përfundim të testimit nga kandidati apo në përfundim të kohës së testimit bëhet mbledhja e testeve dhe e bazës materiale.

2. Në sallë nuk lejohet të hyjë asnjë person tjetër përveç kandidatëve dhe mbikëqyrësve të testimit.

Neni 9

Testimi me shkrim

1. Testimi me shkrim shërben për të vlerësuar nëse kandidati zotëron njohuritë teorike të nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të Policisë së Burgjeve.
2. Testimi me shkrim kryhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga shpallja e listës së kandidatëve, që plotësojnë kriteret ligjore për t'u pranuar në Policinë e Burgjeve.
3. Përpara zhvillimit të vlerësimit me shkrim, testet e kandidatëve pjesëmarrës sekretohen, sipas mënyrës së përcaktuar nga komisioni.
4. Kandidati që ka marrë mbi 60 (gjashtëdhjetë) % të pikëve të përcaktuara për testimin me shkrim, njoftohet për të vazhduar konkurrimin për t'u pranuar në Policinë e Burgjeve.
5. Kandidati, që nuk merr pikët e nevojshme për kalimin me sukses të testimit me shkrim, shkualifikohet nga konkurrimi.
6. Kandidati ka të drejtë të paraqesë ankim me shkrim për rezultatin e testimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi, pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, i cili duhet të shprehet me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve.
7. Rezultatet e testimit me shkrim dalin brenda ditës së testimit. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve merr masa për mundësimin e burimeve infrastrukturore për korrigjimin e testimit brenda ditës.
8. Në përfundim të vlerësimit të testimit me shkrim, lista me rezultatet e testimit në rend zbritës publikohet në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe në faqen zyrtare të saj.
9. Kur nga procesi i konkurrimin rezultojnë fitues më pak se 30 (tridhjetë) % e numrit të vendeve të lira në Policinë e Burgjeve dhe nga mungesa e personelit mund të rrezikohet rendi dhe siguria në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ministri i Drejtësisë vendos me urdhër të veçantë uljen e pragut të pikëve. Në çdo rast, ulja e pragut të pikëve nuk mund të jetë më e vogël se 40 (dyzet) % e pikëve të përcaktuara për testimin me shkrim.

Neni 10

Vlerësimi i aftësive fizike

1. Kandidatët, që kalojnë testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të aftësive fizike, ku përfshihen:
 - a) shpejtësia;
 - b) shkathtësia fizike;
 - c) rezistenca;
 - ç) forca muskulore;
 - d) koordinimi fizik.
2. Testimi i aftësive fizike vlerësohet sipas standardit të përcaktuar në kohën e zhvillimit të testimit nga komisioni i ngritur nga drejtori i Policisë së Burgjeve.
3. Kriteret për kalimin e testit të aftësive fizike janë:
 - a) përfundimi i të gjitha ushtrimeve brenda kohës së caktuar;
 - b) kalimi i të gjitha fazave në rendin e kërkuar.
4. Pas përfundimit, kandidatit i bëhet i ditur rezultati i pikëve dhe nëse ka kaluar apo jo me sukses testimin për të vazhduar fazat e tjera të konkurrimit.
5. Kandidati, që ka marrë mbi 60 (gjashtëdhjetë) % të pikëve të përcaktuara për testin e aftësive fizike, njoftohet për të vazhduar konkurrimin për t'u pranuar në Policinë e Burgjeve.
6. Kandidati, që nuk merr pikët e nevojshme për kalimin me sukses të testimit të aftësive fizike, shkualifikohet nga konkurrimi.
7. Kandidati ka të drejtë të paraqesë ankim me shkrim për rezultatin e testimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi, pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, i cili duhet të shprehet me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve.
8. Ankesat për zhvillimin dhe rezultatin e konkurrimit bëhen në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurave Administrative.
9. Në përfundim të vlerësimit të testimit të aftësive fizike, lista me rezultatet e testimit në rend zbritës publikohet në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe në faqen zyrtare të saj.

Neni 11

Komisioni i vlerësimit të aftësive fizike

1. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve ngre, me urdhër, komisionin për përcaktimin e standardeve të testimit për aftësitë fizike.
2. Komisioni përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të caktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
3. Anëtarët e komisionit të testit fizik u japin udhëzime kandidatëve për të gjithë komponentët, duke i demonstruar me veprime konkrete dhe kryejnë detyrat e mëposhtme:
 - a) Sigurohen që kandidati i kupton veprimet që duhet të kryejë;
 - b) Vëzhgojnë kandidatin gjatë gjithë testimit;
 - c) Shënojnë të gjitha pikët në fletën e testit për çdo kandidat, për secilën garë.
4. Anëtari i komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër të komisionit, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, të mos marrë pjesë në zhvillimin e testimit dhe në vlerësimin e testimit.

Neni 12

Vlerësimi i aftësive profesionale

1. Kandidatët, që kanë aplikuar për pranimin në Policinë e Burgjeve, i nënshtrohen vlerësimit të aftësive profesionale, i cili bëhet në bazë të vlerësimit të arsimimit, të përvojës profesionale të mëparshme dhe të trajnimeve të lidhura me fushën.
2. Me qëllim vlerësimin e aftësive profesionale, kandidati paraqet jetëshkrimin e dokumentet provuese përkatëse.
3. Vlerësimi i aftësive profesionale kryhet nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 13

Testimi me gojë

1. Kandidatët, që rezultojnë fitues në fazat e tjera të testeve, i nënshtrohen testimit me gojë të strukturuar në formën e një interviste. Testimi me gojë zhvillohet nga Komisioni i Përhershëm i Testimit.

2. Para fillimit të intervistës, bëhet sistemimi i ambienteve, ku zhvillohet testimi me gojë, dhe bëhet regjistrimi i kandidatëve që paraqiten. Kandidati, në momentin e regjistrimit, duhet të paraqesë letërnjoftimin.
3. Pyetjet e testimit me gojë dhe pikëzimi i pyetjeve hartohen nga Komisioni i Përhershëm i Testimit dhe nuk kërkojnë njohuri paraprake të teknikave të policisë, por përqendrohen në aftësinë e kandidatit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.
4. Anëtarët e komisionit kryejnë vlerësimin e kandidatit në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri dhe në fund përcaktohet mesatarja e pikëve.
5. Kandidati ka të drejtë të paraqesë ankim me shkrim për rezultatin e testimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi, pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, i cili duhet të shprehet me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve.
6. Ankesat për zhvillimin dhe rezultatin e konkurrimit bëhen në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 14 **Testimi psikologjik i kandidatëve**

1. Kandidatët, që kanë kaluar testimin me shkrim, testimin e aftësive fizike dhe testimin me gojë, i nënshtrohen më pas kontrollit psikologjik, që organizohet nga struktura përgjegjëse për çështjet shoqërore dhe struktura përgjegjëse për çështjet shëndetësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre nga pikëpamja psiko-sociale për të kryer detyrat si punonjës i Policisë së Burgjeve.
2. Në këtë kontroll vlerësohet:
 - a) personaliteti i kandidatit;
 - b) nëse ka prirje që tregojnë se kandidati paragjykon, diskriminon për arsye të etnisë, gjinisë, moshës, prirjes seksuale, racës, fesë, përkatësisë politike, statusit shoqëror apo përkatësisë prindërore;
 - c) nëse manifeston sjellje, të cilat bien në kundërshtim me Kodin e Etikës e të sjelljes profesionale të Policisë së Burgjeve;
 - ç) nëse ka deklaruar të dhëna të rreme për aftësitë personale dhe profesionale, që kanë për qëllim të rrisin mundësitë për punësim të kandidatit;

- d) nëse rezulton se është përdorues droge apo përdorues i vazhdueshëm i pijeve alkoolike në masën që ndikojnë në aftësinë e tij për të përmbushur detyrat si punonjës i Policisë së Burgjeve.
3. Testimi psikologjik i kandidatëve për punonjës të Policisë së Burgjeve nuk vlerësohet me pikë. Strukturat përgjegjëse vlerësojnë vetëm përshtatshmërinë e kandidatit për të qenë ose jo pjesë e Policisë së Burgjeve. Gjatë zhvillimit të testimit punonjësit që zhvillojnë vlerësimin mbajnë procesverbal, i cili nënshkruhet në fund edhe nga kandidati.
 4. Vlerësimi i kryer nga strukturat përgjegjëse i dërgohet Komisionit të Përhershëm të Testimit. Nëse vlerësohet se kandidati nuk është i përshtatshëm për t'u pranuar si punonjës i Policisë së Burgjeve, kandidati shkualifikohet nga konkurrimi.
 5. Në rast se kandidati nuk rezulton i përshtatshëm për t'u pranuar si punonjës i Policisë së Burgjeve, njoftohet jo më vonë se e nesërmja e përfundimit të procesit të testimit psikologjik, duke i dhënë me shkrim arsyen e përjashtimit. Kandidati ka të drejtë të paraqesë ankim me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi, pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, i cili duhet të shprehet me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve.
 6. Ankesat për zhvillimin dhe rezultatin e konkurrimit bëhen në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 15 **Rezultati i përgjithshëm**

1. Rezultati i përgjithshëm i kandidatit përcaktohet mbi shumatoren e rezultateve të arritura nga testimi me shkrim, vlerësimi i aftësive fizike dhe profesionale dhe testimi me gojë.
2. Testimi me shkrim, vlerësimi i aftësive fizike, vlerësimi profesional dhe testimi me gojë kanë një total prej 100 (njëqind) pikësh, të cilat ndahen përkatësisht:
 - a) testimi me shkrim përmban 60 (gjashtëdhjetë) pikë;
 - b) vlerësimi i aftësive fizike përmban 20 (njëzet) pikë;
 - c) vlerësimi profesional përmban 10 (dhjetë) pikë;
 - ç) testimi me gojë përmban 10 (dhjetë) pikë.
3. Kandidatët renditen në listën përfundimtare sipas rezultateve të arritura në rend zbritës, sipas pikëve totale të marra.

4. Në rastet kur 2 (dy) ose më shumë kandidatë rezultojnë me pikë të barabarta, atëherë renditja e tyre bëhet nëpërmjet shortit.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve shpall publikisht listën e kandidatëve fitues jo më vonë se e nesërmja e ditës së përfundimit të procesit të vlerësimit të testimit të fundit, si dhe njofton individualisht kandidatët fitues.
6. Lista e kandidatëve që kanë rezultuar të suksesshëm është e vlefshme për 1 (një) vit, duke filluar nga data e përfundimit të procesit të pranimit.
7. Për vendet e tjera të lira, që krijohen brenda një viti, pranimi bëhet nga kandidatët vijues që renditen në listën e kandidatëve, të cilët kanë rezultuar të suksesshëm.
8. Çdo kandidat, i cili nuk kalon ndonjërin prej fazave të procesit të testimit, në rast riaplikimi, duhet ta rifillojë procesin nga e para.
9. Dokumentacioni i kandidatëve që nuk rezultojnë fitues administrohet nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve deri në momentin e fillimit të procedurës pasardhëse të pranimit e më pas asgjësohet.

KREU III

RREGULLAT E DETAJUARA PËR TRAJNIMIN E PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE

Neni 16

Trajnimi fillestar

Kandidati, i cili përzgjidhet për t'u pranuar si punonjës i Policisë së Burgjeve sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve, kryen trajnimin fillestar, jo më vonë se 30 (ditë) ditë nga shpallja e listës emërore të fituese, i cili konsiston në dhënien e njohurive teorike e praktike, në bazë të një programi mësimor, që përmban detyrat kryesore të punës për sigurinë, trajtimin dhe rehabilitimin social të të burgosurve.

Neni 17

Kryerja e trajnimit fillestar

1. Punonjësit e Policisë së Burgjeve kryejnë trajnimin fillestar sipas moduleve të miratuara për një periudhë 3-mujore për përvetësimin e njohurive të posaçme teorike dhe praktike të punës.

2. Gjatë trajnimit fillestar, punonjësi i Policisë së Burgjeve njihet me rregullat e sjelljes dhe Kodin e Etikës, të drejtat dhe liritë e të burgosurve, respektimin dhe mbrojtjen e tyre.
3. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me të burgosurit, trajnohen për teknikat që bëjnë të mundur përdorimin minimal të forcës, me qëllim respektimin e të drejtave dhe dinjitetin e të burgosurve dhe mostejkalimin e masës së forcës për neutralizimin e të burgosurve.
4. Punonjësit e Policisë së Burgjeve ndjekin modulet e trajnimit fillestar lidhur me përdorimin e armëve dhe të pajisjeve të tjera kufizuese, në respektim të rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për përdorimin e armëve, si dhe aktet nënligjore në fuqi të nxjerra në zbatim të legjislacionit për Policinë e Burgjeve.
5. Ndjekja e trajnimit teorik e praktik është e detyrueshme për punonjësit e Policisë së Burgjeve. Mungesa në më shumë se 10 (dhjetë) % të orëve të programit të trajnimit sjell shkualifikimin e punonjësit të Policisë së Burgjeve nga procedura të mëtejshme për të ushtruar detyrën si aspirant në Policinë e Burgjeve.

Neni 18

Programet e trajnimit fillestar

1. Programet për trajnimin fillestar të punonjësve të Policisë së Burgjeve hartohen nga Qendra e Trajnimit dhe miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.
2. Programi përmban linjat kryesore, temat për çdo linjë, orët për leksione, orët e seminareve, si dhe orët e praktikës.
3. Programi i trajnimit fillestar përmban njohuri për:
 - a) trajtimin e të burgosurve dhe të drejtat e tyre;
 - b) rastet dhe mënyrat e përdorimit të forcës;
 - c) rastet dhe mënyrat e përdorimit të armëve, si dhe të pajisjeve të tjera të Policisë së Burgjeve;
 - ç) strukturat dhe organizimin e sistemit të burgjeve;
 - d) skemat e sigurisë;
 - dh) rregullat për hyrje-daljet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe të drejtat e detyrimit e vizitorëve;
 - e) rregullat për ruajtjen e institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë;

- ë) reagimin dhe përshtatjen me rrethana dhe situata specifike gjatë ushtrimit të detyrës;
 - f) rregullat për ushtrimin e kontrolleve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
 - g) zhvillimin e aftësive në fushën e policisë;
 - gj) zbatimin e rregullave, disiplinës dhe të etikës.
4. Programi përmban rregulla të posaçme për trajtimin e të burgosurve të mitur, grave, personave me aftësi të kufizuara, të huajt dhe personat me nevoja të veçanta.
 5. Programi, sipas pikës 3, të këtij neni, zbatohet nëpërmjet moduleve të trajnimit, trajnimit praktik, si dhe punës praktike që i caktohet kandidatit nga Qendra e Trajnimit.
 6. Për raste të veçanta, nisur nga ndryshimet që pëson legjislacioni dhe problemet e praktikës, karakteri i programit të formimit fillestar mund të lejojë përfshirjen edhe të tematikave të tjera, të cilat ndihmojnë në formimin profesional të punonjësve të Policisë së Burgjeve.
 7. Në përfundim të çdo teme mësimore të programit të trajnimit fillestar, kandidatëve për punonjës të Policisë së Burgjeve u përcillet një kopje elektronike e temës përkatëse dhe një listë sintetike bibliografie e materialeve, ku stafi mësimdhënës është mbështetur, si dhe materialet që sugjerohen për studime të mëtejshme të thelluara.

Neni 19

Përfundimi i trajnimit fillestar

1. Në përfundim të trajnimit, kandidati vlerësohet me shkrim për përvetësimin e njohurive bazuar në programin e trajnimit, si dhe në punën gjatë praktikës. Testimi me shkrim zhvillohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e përfundimit të trajnimit.
2. Testimi dhe vlerësimi i njohurive të kandidatit bëhet nga Qendra e Trajnimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
3. Testimi konsiderohet i kaluar me sukses kur kandidati merr mbi 50 (pesëdhjetë) % të pikëve të testimit.
4. Me përfundimin me sukses të trajnimit fillestar, Qendra e Trajnimit pajis punonjësin e Policisë së Burgjeve me certifikatën e formimit fillestar.

5. Pas përfundimit të periudhës së trajnimit fillestar dhe kalimit me sukses të tij, punonjësi i Policisë së Burgjeve ushtron detyrën për një periudhë prove 1-vjeçare gjatë së cilës konsiderohet si aspirant në Policinë e Burgjeve.

Neni 20

Trajnimet e vazhdueshme

1. Pas emërimit në pozicionin përkatës, punonjësi i Policisë së Burgjeve ndjek trajnimin e vazhdueshëm, me qëllim përmirësimin e aftësive të duhura profesionale për përmbushjen e detyrave. Trajnimit të vazhdueshëm i nënshtrohen edhe punonjësit e Policisë së Burgjeve, të cilët janë pranuar në Policinë e Burgjeve përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
2. Trajnimi i vazhdueshëm planifikohet nga Qendra e Trajnimit, gjatë gjithë vitit kalendarik, bazuar në nevojat për trajnim, sipas detyrave dhe përgjegjësi që kanë punonjësit e Policisë së Burgjeve.
3. Programet vjetore të trajnimit të vazhdueshëm hartohen nga Qendra e Trajnimit dhe miratohen me urdhër nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.
4. Koha, vendi dhe mënyra e zhvillimit të trajnimeve vazhduese, sipas fushave të përgjegjësi, përcaktohen në urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, me propozimin e drejtorit të Policisë së Burgjeve.
5. Ndjekja e trajnimeve vazhduese është e detyrueshme për punonjësit e Policisë së Burgjeve, të cilët janë njoftuar për ndjekjen e trajnimit përkatës.

Neni 21

Programet e trajnimit të vazhdueshëm

Gjatë trajnimit vazhdues, punonjësi i Policisë së Burgjeve duhet të përvetësojë njohuritë dhe aftësitë, si më poshtë, por pa u kufizuar vetëm në to:

- a) Për paraqitje të suksesshme profesionale si punonjës i Policisë së Burgjeve;
- b) Për t'u përballur me kërkesa dhe sfida, që ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë ushtrimit të detyrës;
- c) Aftësi profesionale, metodike, sociale dhe personale për të ushtruar detyrat e kërkuara në punë;
- ç) Për zhvillimin e aftësive praktike gjatë ushtrimit të detyrës;
- d) Për zhvillimin e aftësive menaxheriale për përmbushjen me sukses të procesit të punës;
- dh) Për rregullat e legjislacionin në fuqi për elementet që prekin veprimtarinë e Policisë së Burgjeve;

- e) Për rregullat e etikës e të sjelljes profesionale të Policisë së Burgjeve;
- ë) Për trajtimin e grupeve të veçanta të të burgosurve.

Neni 22

Përfundimi i trajnimit vazhdues

1. Në përfundim të trajnimit vazhdues, punonjësi i Policisë së Burgjeve pajiset me certifikatë për kryerjen e trajnimit vazhdues.
2. Punonjësit e Policisë së Burgjeve i nënshtrohen vlerësimit vjetor nga eprori direkt për mbarëvajtjen në punë dhe përfitimin e njohurive shtesë, sipas moduleve të programeve të trajnimit vazhdues.

Neni 23

Administrimi i të dhënave për trajnimet

Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve administron të dhënat e të gjithave trajnimeve që ndjek Policia e Burgjeve, në formë elektronike dhe në formë shkresore, në një regjistër të posaçëm, në të cilin përcaktohen të dhënat e punonjësit që ka ndjekur trajnimin, tematika e trajnimit dhe kohëzgjatja e tij.

KREU IV

ECURIA NË GRADË

Neni 24

Parime të përgjithshme

1. Punonjësit e Policisë së Burgjeve kanë të drejtën të fitojnë ngritje në gradë, në zbatim të legjislacionit në fuqi për Policinë e Burgjeve.
2. Ngritja në gradë e punonjësit të Policisë së Burgjeve nënkupton ngritjen e tij në detyrë, sipas funksioneve korresponduese për çdo gradë.
3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ngrihet në gradën pasardhëse dhe caktohet në detyrë më të lartë vetëm pasi të ketë plotësuar kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve dhe këtë rregullore. Ngritjet në gradë bëhen vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë.
4. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, që plotësojnë kriteret ligjore për ngritje në gradë, ndjekin kursin e trajnimit profesional për marrjen e gradës së radhës.
5. Në përfundim të trajnimit, punonjësit i nënshtrohen testimit me shkrim, me

qëllim vlerësimin e njohurive të përfituara gjatë testimit.

6. Pas kalimit me sukses të testimit me shkrim, punonjësit e Policisë së Burgjeve i nënshtrohen procesit të vlerësimit nga komisioni i vlerësimit për dhënien e gradës së radhës.
7. Bazuar në rezultatet e testimit me shkrim dhe të vlerësimit, komisioni i vlerësimit për dhënien e gradës së radhës propozon dhënien ose jo të gradës.

Neni 25

Kriteret për fitimin e gradës

1. Ecuria në gradë e punonjësit të policisë bëhet nëpërmjet fitimit të njëpasnjëshëm të gradave, në përputhje me kriteret dhe afatet e përcaktuara për çdo gradë në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve.
2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, pasi ka fituar gradën, ka të drejtë të aplikojë për fitimin e gradës policore të radhës, kur plotëson kriteret e përcaktuara.
3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, për fitimin e gradës së radhës, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) Të ketë vlerësim vjetor pozitiv të punës gjatë kohës së qëndrimit në gradë;
 - b) Të përmbushë kriteret për pozicionin e punës, sipas fushës së shërbimit;
 - c) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi për shtyrjen e afatit të ngritjes në gradë, sipas parashikimeve në legjislacionin për Policinë e Burgjeve;
 - ç) Të ketë përfunduar me sukses trajnimin profesional për marrjen e gradës së radhës;
 - d) Të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtme:

i. nga “nëninspektor” në “inspektor”	4 vjet;
ii. nga “inspektor” në “kryeinspektor”	5 vjet;
iii. nga “kryeinspektor” në “nënkomisar”	5 vjet;
iv. nga “nënkomisar” në “komisar”	3 vjet;
v. nga “komisar” në “kryekomisar”	4 vjet;
vi. nga “kryekomisar” në “drejtues”	5 vjet.
4. Në vjetërsinë për efekt konkurrimi për fitimin e gradës llogaritet edhe koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të:
 - a) paaftësisë shëndetësore, deri në 6 (gjashtë) muaj, brenda afatit 12-mujor;
 - b) vjetërsisë së shërbimit të njohur me vendim gjyqësor;
 - c) lejes së lindjes.

5. Në vjetërsinë për efekt gradimi nuk llogaritet koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të lejes së përfituar pa të drejtë page.

Neni 26

Procesi i ngritjes në gradë

1. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, në varësi të nevojave dhe të vendeve të lira për çdo gradë, miraton, brenda datës 31 mars të çdo viti kalendarik, urdhrin për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës korresponduese, ku përcaktohen:
 - a) numri i funksioneve të lira për gradën përkatëse;
 - b) data e fillimit dhe e përfundimit të procesit të aplikimit;
 - c) rregullat, procedurat dhe fazat e konkurrimit;
 - ç) komisioni i vlerësimit për dhënien e gradave;
 - d) komisioni i apelimit.
2. Struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore njofton punonjësit e Policisë së Burgjeve zyrtarisht për fillimin e procesit të konkurrimit nëpërmjet formave të komunikimit elektronik, si dhe publikon njoftimin në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
3. Në rastin e dhënien së gradave të rolit të lartë, ministri i Drejtësisë përcakton përbërjen e komisionit të vlerësimit për dhënien e gradave brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i urdhrin të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës korresponduese.
4. Afati i përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, për përfundimin e procesit të aplikimit, nuk mund të jetë më shumë se 20 (njëzet) ditë.

Neni 27

Aplikimi për ngritje në gradë

1. Punonjësit, që kanë interes të marrin pjesë në procesin e përzgjedhjes për ngritje në gradë, aplikojnë pranë strukturës së personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.
2. Punonjësit paraqesin kërkesën për shprehjen e interesit dhe dokumentet provuese për përmbushjen e kriterëve për ngritje në gradë, sipas parashikimeve të bëra në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve, si dhe në këtë rregullore.

Neni 28

Verifikimi i kandidatëve

1. Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve verifikon dokumentacionin e përcjellë nga punonjësit e Policisë së Burgjeve për ngritje në gradë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit.
2. Pasi shqyrton aplikimet e punonjësve për ngritje në gradë, struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve harton listën e punonjësve që plotësojnë kriteret për ngritje në gradë dhe ia përcjell komisionit përgjegjës për ngritjen në gradë, si dhe Qendrës së Trajnimit.
3. Lista e punonjësve, që plotësojnë kriteret për ngritje në gradë, i njoftohet punonjësve individualisht, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke njoftuar edhe datën e fillimit të trajnimit, trajnimin profesional për fitimin e gradës së radhës.
4. Punonjësve të shkualifikuar u komunikohet arsyeja e argumentuar për mospërfshirjen në listë, si dhe e drejta për të paraqitur ankim me shkrim, sipas parashikimeve të bëra në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve.

Neni 29

Trajnimi profesional për marrjen e gradës së radhës

1. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, të cilët plotësojnë kushtet bazë për fitimin e gradës së radhës, duhet të ndjekin trajnimin e posaçëm profesional për fitimin e gradave.
2. Trajnimi që ndjekin punonjësit e Policisë së Burgjeve është i veçantë për secilën nga gradat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve, gjatë së cilit kandidatët përfitojnë njohuri lidhur me detyrat e përgjegjësitë e kategorisë së gradës për të cilën kanë aplikuar.
3. Qendra e Trajnimit harton programet për kalimin në një gradë më të lartë sipas legjislacionit në fuqi për Policinë e Burgjeve.
4. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga përfundimi i trajnimit, kandidatët i nënshtrohen testimit nga komisioni përgjegjës për testimin e punonjësve për ngritjen në gradë, lidhur me njohuritë e përfituara gjatë trajnimit.

Neni 30

Përbërja e komisionit të testimit për ngritjen në gradë

1. Komisioni i testimit për ngritjen në gradë përbëhet nga:
 - a) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për drejtësinë;
 - b) dy përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
 - c) një përfaqësues nga Qendra e Trajnimit.
2. Anëtarët e komisionit të testimit për ngritjen në gradë caktohen për një periudhë 1-vjeçare.
3. Anëtarët e komisionit, në ushtrimin e detyrave, deklarojnë, në çdo rast, nëse janë në kushtet e konfliktit të interesit. Anëtari i komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër të komisionit, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, të mos marrë pjesë në zhvillimin e testimit e në vlerësimin e tij.

Neni 31

Testimi për ngritje në gradë

1. Komisioni përgjegjës për testimin për ngritjen në gradë administron dhe menaxhon fazat e testimit për ngritje në gradë.
2. Për ngritje nga grada “nëninspektor” deri në “drejtues”, faza e parë e përzgjedhjes është provim me shkrim, për të testuar njohuritë teknike të kandidatit në fushën e legjislacionit në fuqi për Policinë e Burgjeve, të legjislacionit penal, të legjislacionit bazë administrativ dhe aftësitë bazë të drejtimit.
3. Kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit përkatës nuk mund të jetë më i ulët se 70 (shtatëdhjetë) % e vlerës së përgjithshme të pikëve të testimit.
4. Rezultatet e testit me shkrim përbëjnë 50 (pesëdhjetë) % të rezultatit të përgjithshëm të kandidatit për fitimin e gradës së radhës.
5. Kandidatët njoftohen me shkrim për rezultatin e testimit. Kandidatët, të cilët nuk kanë marrë pikët e nevojshme për kalimin me sukses të testimit me shkrim, kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim, sipas parashikimeve të bëra në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve.

6. Komisioni përgjegjës për testimin për ngritjen në gradë harton listën e kandidatëve në rend zbritës e sipas funksioneve përkatëse dhe të rezultateve të testimit.
7. Rezultatet e testit hidhen në bazën e të dhënave të personelit për gradimet dhe veprimtaritë lidhur me to dhe i përcillen komisionit të vlerësimit për ngritje në gradë për të vijuar me procesin e vlerësimit. Lista e kandidatëve të kualifikuar publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 32

Procesi i vlerësimit të aftësive për ngritje në gradë

1. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi listës së kandidatëve që kalojnë me sukses testimin me shkrim, për ngritjen në gradë nga “nëninspektor” deri në “drejtues”, zhvillohet procesi i vlerësimit për:
 - a) aftësitë komunikuese;
 - b) aftësitë menaxhuese dhe drejtuese;
 - c) aftësitë vendimmarrëse;
 - ç) njohuritë dhe përvojat profesionale;
 - d) aftësitë gjyqësore;
 - dh) motivimin personal;
 - e) legjislacionin dhe instrumentet ndërkombëtare të sistemit të burgjeve.
2. Kufiri minimal për kalimin me sukses të vlerësimit të punonjësit të Policisë së Burgjeve nuk mund të jetë më i ulët se 70 (shtatëdhjetë) % e vlerës së përgjithshme të pikëve të vlerësimit.
3. Totali i mesatares së rezultateve, që secili vlerësues i jep kandidatit, përbën 50 (pesëdhjetë) % të rezultatit të përgjithshëm.

Neni 33

Komisionet e vlerësimit

1. Komisionet e vlerësimit për dhënien e gradave për rolin bazë, të mesëm dhe të lartë propozojnë dhënien e gradave përkatëse në bazë të rezultateve të testimit dhe të vlerësimit të kriterëve të parashikuara në ligjin në fuqi për Policinë e Burgjeve dhe këtë rregullore.
2. Vlerësimi i kandidatit përfshin plotësimin e kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore gjatë fazës së aplikimit, testimit, trajnimit e deri në momentin e propozimit për dhënien e gradës.

3. Përbërja dhe funksionimi i komisionit të vlerësimit për dhënien e gradave për rolin bazë dhe të mesëm përcaktohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.
4. Përbërja dhe funksionimi i komisionit të vlerësimit për dhënien e gradave për rolin e lartë përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 34

Vlerësimi përfundimtar i ngritjes në gradë

1. Pas përfundimit të vlerësimit, renditja e kandidatëve bëhet sipas shumatores së pikëve të arritura gjatë testimit dhe vlerësimit për gradën përkatëse, duke filluar nga punonjësi, i cili ka vlerësimin më të lartë, duke bërë listim të ndarë ndërmjet fituesve dhe listës së pritjes.
2. Nëse në përfundim të procedurës për marrjen e gradës kualifikohen më shumë kandidatë sesa janë vende të lira, kandidatët qëndrojnë në listë pritjeje. Afati i qëndrimit në listë pritjeje për dhënien e gradës nuk mund të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Nëse brenda këtij afati nuk bëhet e mundur dhënia e gradës, punonjësi i nënshtrohet konkurrimit të radhës.

Neni 35

Dhënia e gradës

1. Në përfundim të procesit të testimit e të vlerësimit, dhënia e gradës bëhet me urdhër të autoriteteve përgjegjëse për dhënien e gradave, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve, bazuar në propozimin e komisionit të vlerësimit. Në urdhrin për dhënien e gradës përcaktohet edhe funksioni që do të kryejë punonjësi.
2. Punonjësit, të cilët nuk kanë rezultuar fitues për gradën e radhës apo nuk janë dakord me rezultatin përfundimtar të vlerësimit, kanë të drejtë të paraqesin ankim brenda 5 (pesë) ditëve pranë gjykatës kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 36

Ulja në gradë dhe caktimi në detyrë

1. Me përjashtim të rolit bazë, kur, për shkak të ndryshimeve në strukturën organizative të policisë, shkurtohet numri i funksioneve organike për gradë, punonjësi i policisë, që mban gradën, për të cilën do të kërkohet ulja, mund të kërkojë ulje në gradë dhe t'i caktohet detyrë më e ulët, kur ka vende të lira. Në këtë rast, ulja në gradë i kërkohet punonjësit me vjetërsinë më të vogël në

punë.

2. Me krijimin e vendeve të lira për gradë, punonjësi i policisë, që ka kërkuar uljen në gradë, rimerr, brenda 2 (dy) vjetëve, gradën e mëparshme.

Neni 37

Heqja dorë nga grada

1. Çdo punonjës i Policisë së Burgjeve ka të drejtë të kërkojë që të transferohet në funksione organike brenda së njëjtës gradë ose në funksione që kanë gradë më të ulët. Për t'u transferuar në funksion, që i korrespondon një grade më të ulët, punonjësi i policisë kërkon gjithashtu ulje në gradë.
2. Heqja dorë nga grada, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të kërkohet vetëm për një gradë paraardhëse dhe jo më shumë se në 2 (dy) raste gjatë karrierës së punonjësit.
3. Vendimi për kërkesën e punonjësit të policisë për heqje dorë nga grada merret nga autoriteti përkatës që ka dhënë gradën.
4. Punonjësi i policisë, i cili më parë ka hequr dorë me kërkesën e vet nga një gradë, ka të drejtë të kërkojë ngritje në gradë vetëm pas certifikimit nga komisioni i vlerësimit për dhënien e gradave, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve dhe në këtë rregullore.

Neni 38

Programet e kalimit në gradë

Qendra e Trajnimit, krahas programit të formimit fillestar, harton programet për kalimin në një gradë më të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për Policinë e Burgjeve.

Neni 39

Administrimi i të dhënave mbi gradat

Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve administron të dhënat e ngritjes në gradë për të gjithë punonjësit e Policisë së Burgjeve, në formë elektronike dhe në formë shkresore, në një regjistër të posaçëm, në të cilin përcaktohen të dhënat e punonjësit, grada që mban dhe data e marrjes së gradës.

NR.PROT. 3137/1
DATË 10.6- 2022

MINISTRISË SË DREJTËSISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI
The image shows a circular official stamp of the Ministry of Justice of the Republic of Albania. The text around the stamp reads "REPUBLIKA E SHQIPËRI" at the top and "MINISTRAT E DREJTËSISË" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink.